LIGJ
Nr.9903, datë 17.4.2008

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË LIGJIN NR.7952, DATË 21.6.1995 "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim dhe shtesë:

Neni 1

Neni 54 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 54

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikat e zhvillimit të arsimit parauniversitar.

2. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar këshillon, formulon mendime dhe propozime për:

a) hartimin e strategjive dhe të programeve kombëtare për arsimin parauniversitar, drejtimet e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore;

b) reformën e kurrikulave dhe të teksteve për arsimin parauniversitar;

c) projektbuxhetin e parashikuar për arsimin parauniversitar dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;

ç) standardet për vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar;

d) zhvillimin e politikave të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe rrugët e financimit të tyre.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Pas nenit 54 shtohet neni 54/a me këtë përmbajtje:

"Neni 54/a

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar përbëhet nga 23 anëtarë, si më poshtë: Ministri i Arsimit dhe Shkencës, një përfaqësues nga drejtoritë arsimore rajonale, një përfaqësues i Ministrisë së Financave, një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, një përfaqësues i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë, një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, një përfaqësues i shoqatës së bashkive, një përfaqësues i shoqatës së komunave, një përfaqësues i shoqatës së këshillave të qarqeve dhe 13 anëtarë të tjerë, ekspertë të zgjedhur me konkurrim publik. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar kryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

2. Anëtarët, ekspertë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, janë figura të njohura për kontributin e tyre shkencor në fushën e arsimit dhe të shkencës, që zotërojnë, së paku, diploma të nivelit të dytë dhe të nivelit të dytë të integruar dhe kanë njohje të mirë të përvojës ndërkombëtare në

fushën e zhvillimit të arsimit parauniversitar. Ata përzgjidhen me konkurrim publik nga një komision i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe një përfaqësues nga Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional, të caktuar nga vetë këto institucione.

3. Komisioni i përzgjedhjes, pasi shqyrton plotësimin e kritereve profesionale, në përputhje me këtë ligj, rendit në një listë kandidatët, sipas pikëve të fituara. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve caktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe bëhen publike.

4. Këshilli i Ministrave cakton në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar 13 nga kandidatët e klasifikuar.

5. Anëtarët ekspertë zgjidhen për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

6. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar mbështetet nga një sekretariat teknik, që ndodhet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Pagesa e anëtarëve të këtij këshilli, si dhe përbërja e detyrat e anëtarëve të sekretariatit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5696, datë 5.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi